



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME

## Zhvillohet aktiviteti promovues me rastin e akordimit të gradës diplomatike “ambasador” për Dashnor Dervishi dhe Ilir Boçka

2017-12-20 14:33:00



### Nderim dy kolosëve që shërbyen në dy regjime të ndryshme politike

U zhvillua sot në orën 9.30, pranë ambienteve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, aktiviteti promovues me rastin e akordimit nga Presidenti i Republikës të gradës diplomatike, “Ambasador i Shqipërisë” dy diplomatëve të karrierës në Shërbimin tonë të Jashtëm, Dashnor Dervishi dhe Ilir Boçka.

Dy ambasadorët janë diplomatë profesionistë që i shërbyen vendit të tyre në dy regjime të ndryshme politike, në dy rende të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare, me të njëjtin profesionalizëm, korrektesë zyrtare dhe atdhedashuri, në mbrojtje të interesave tona kombëtare. Puna e tyre diplomatike, tashmë në formën e rekordeve arkivore shumë të pasura që gjenden pranë Arkivit Historik të diplomacisë shqiptare, dëshmon qartë sesi diplomacia ka fuqinë të ndikojë në vendimmarrje të rëndësishme për vendin, kur politika është në dilemat e saj të koklavitura.

Aktiviteti diplomatik i ambasadorëve dhe figura e tyre zyrtare, janë një model për t'u referuar nga brezi i ri i diplomatëve, si shembull i profesionalizmit, finesës dhe teknikave diplomatike, maturisë dhe gjakftohësisë në vendimmarrje të rëndësishme.

Gjatë fjalës së tij, ambasadori Dervishi solli për të pranishmit disa prej momenteve kryesore të karrierës 40-vjeçare, që prej vitit 1976 kur nisi punën në Shërbimin e Jashtëm.

“Kam pasur fatin që në 4 dekada të jem pjesë e ngjarjeve me ndikim të madh në vendin tonë sa i përket marrëdhënieve me Jashtë. Kujtoj fundin e viteve '80-të, mesin e viteve '90-të, kohën pas rënies së Murit të Berlinit, atëherë Roma, ku unë isha caktuar ambasador, ishte vendi që kujdesej për ndryshime të buta”, shprehet ambasadori Dervishi duke veçuar gjithashtu, edhe ndikimin në marrëdhëniet me fqinjin tonë jugor, Greqinë.

“Ambasadori ishte dikur emblema e shtetit të cilin përfaqësonte, kurse sot, i ka mbetur më pak, për shkak të ndryshimeve globale dhe dinamikës së zhvillimit të ngjarjeve, dhe jo vetëm në Shqipëri. Këto ndryshime e bëjnë më të vështirë punën e një ambasadori, ndaj është i nevojshëm, akordimi i stimujve moralë për ta”, u shpreh ambasador Dervishi që në fund të fjalës së tij falënderoi ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati për vëmendjen dhe kontributin e treguar lidhur me akordimin e gradës diplomatike. Në fjalën e tij, ambasador Ilir Boçka e konsideroi si çmim Oskar për karrierën e tij akordimin e gradës diplomatike “ambasador”, si vlerësim të punës së tij si diplomat, por edhe si njeri, si mbrojtës i interesave të shtetasve shqiptarë. Ambasadori i atribuoi meritat për këtë titull, familjes, por edhe të gjithë kolektivit me të cilin ka bashkëpunuar gjatë karrierës së tij.

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati, në fjalën e tij përshëndetëse, tha se, akordimi i gradës ambasador, e bën ditën e sotme, një ditë të shënuar, jo vetëm se u dhurohet emocion dy personaliteteve të diplomacisë shqiptare, por edhe se hapet një fazë e re, vendoset një standard i ri për brezat e ardhshëm në Shërbimin e Jashtëm shqiptar.

“Pecsi se ne sot kemi vendosur një standard të ri edhe për brezat e

gjeneratat e tjerë të Shërbimit të Jashtëm, që me punë, me kontribut dhe me përkushtim ndaj mbrojtjes së interesave tona kombëtare dhe promovimit të vlerave tona më të mira, edhe në Shërbimin e Jashtëm, pavarësisht sakrificave të panumërta, në fund të ditës njerëzit shpërblehen dhe ne kemi mundësi se çfarë t'u tregojmë edhe gjeneratave të tjera për këtë proces", deklaroi ministri Bushati.

Duke cilësuar ambasadorët Dervishi dhe Boçka si dy personalitete, dy kolosë në fushën e diplomacisë, karriera e të cilëve shtrihet nga epoka e Luftës së Ftohtë, deri në epokën digjitale, ministri tha se roli i tyre ka qenë themelor, sa i përket vendimmarrjes në Shërbimin e Jashtëm.

"Megjithëse ne kemi pësuar një transformim të madh, megjithëse roli i ambasadorit nuk është më ai që ishte në kuptimin tradicional të fjalës, pasi urat e komunikimit dhe mjetet janë të shumfishta, gjithsesi mendja, analiza, fytyra e ambasadorit janë vendimtare për disa prej vendimeve që merren në politikën e Jashtëme", u shpreh ministri Bushati.

Ministri vlerësoi në mënyrë të veçantë rolin dhe profesionizmin e ambasadorit Dervishi në arritjen e marrëveshjes së toponimeve me Greqinë, pas 9 raundesh të gjata diskutimesh dhe kontributin e veçantë të ambasadorit Boçka në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe në tejkalimin me finesë të incidentit të dronit në Beograd.

Ministri Bushati, falënderoi edhe presidentët Nishani dhe Meta për kontributin e tyre në finalizimin e procesit të akordimit të gradës diplomatike "Ambasador" për Dashnor Dervishin dhe Ilir Boçkën.

Gjatë aktivitetit, Ksenofon Krisafi dhe Plator Kalakula sollën refleksione dhe kujtime, respektivisht për ambasadorin Dashnor Dervishi dhe ambasadorin Ilir Boçka.

Gjithashtu, për të pranishmit, u sollën fotografi dhe dokumente arkivore për dy ambasadorët, nëpërmjet një prezantimi me video. Aktiviteti u përmbyll me një koktejl për të pranishmit.